



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 304/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosja (LVV), dega në Suharekë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Suharekë, për shkak të gjatë mbajtjes së tubimit publik, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Lëvizja Vetëvendosja (LVV), dega në Suharekë.

Arsyetim

Me datën 22.10.2013, Lëvizja Vetëvendosja ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën pretendohet se subjekti politik AAK e ka penguar gjatë mbajtjes së tubimit elektoral duke mbajtur tubimin në të njëjtin vend edhe pse LVV e ka lajmëruar KKZ-në, në Suharekë përmes njoftimit të deponuar pran ZLKKZ, për mbajtjen e tubimit politik për datën 18 tetor 2013, në ora 19:00, në Objektin e Qendrës së Kulturës në fshatin Mushtisht të komunës së Suharekës. Edhe pse tubimi elektoral ishte i paralajmëruar në KKZ nga LVV-ja, ndërsa AAK më 18 tetor në ora 19:00 në të njëjtin lokacion ka mbajtur tubimin politik të emëruar “Party me të rinj”.

Në cilësinë e provës, parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur njoftimin e LVV- ZLKKZ-së si dëshmi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik AAK, me datën 24.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 25.10.2013, brenda afatit të caktuar PZAP-i pranoi përgjigjen në ankesë, në të cilën theksohet se nuk ka mbajtur tubim në Qendrës së Kulturës në Mushtisht të Suharekës me datë 18 tetor 2013 në ora 19:00, në atë qendër siç pretendohet në ankesë por ka pasur vetëm njoftim për simpatizantët e AAK-së për tubimin që është mbajtur në Restorantin –Pishina, festa “party me të rinj” në fshatin Baqevc me të pranuar njoftimin për ankesë ka kontaktuar strukturat menaxhuese të fushatës, konkretisht shtabin zgjedhor për Komunën e Suharekës, të cilët e argumentuan me prova aktivitetin me të rinj të mbajtur në fshatin Baqevc. Aktivitetet për të cilat LVV pretendon që është mbajtur në qendrën e kulturës në fshatin Mushtisht.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Me ankesën e parashtruar të LVV, pretendohet se subjekti politik AAK, ka mbajtur tubimin publik në të njëjtën kohë me LVV, ndonëse tubimi ishte i paralajmëruar në KKZ nga LVV, PZAP-i konstatoi pretendimet ankimore nuk qëndrojnë sepse dëshmia e ofruar nga parashtruesi i ankesës nuk është dëshmi me të cilën vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar siç pretendohet në ankesë, andaj një pretendim i tillë u vlerësua si i pabazuar dhe ne kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

A nr. 304/2013 më datën 25.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Nehat Idrizi**



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*